



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



# UDHËZUES PËR PËRDORUESIT



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE  
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



A.L.T.R.I




*Ky dokument u realizua në kuadër të projektit "Shoqëria civile kundër korrupsionit, nga një sfidë vendase në një përgjigje Evropiane!", financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Qendrës ALTRI dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian.*

# Përmbajtja

1. Hyrje - Çfarë është platforma? .....	2
2. Si ta gjej dhe si të hyj në platformë .....	3
3. Si të regjistrohem dhe të krijoj llogari .....	4-5
4. Seksionet kryesore të platformës .....	5
5. Si të kontribuoj dhe të përfshihem aktivisht .....	6
6. Anëtarësimi dhe roli i përdoruesit .....	6
7. Këshilla për përdorim efikas .....	7
8. Mbështetje dhe kontakt .....	7

# 1. Hyrje - Çfarë është platforma?



**RrjetiAntiKorrupsion.al** është një hapësirë digjitale bashkëpunimi, që lidh organizatat e shoqërisë civile, institucionet publike, median, biznesin dhe qytetarët, me qëllim forcimin e luftës kundër korrupsionit.

## Në platformë do të gjeni:



Raporte, studime dhe materiale mbi korrupsionin



Diskutime dhe forume tematike



Informacion mbi anëtarët dhe aktivitetet e rrjetit




Mjete praktike për denoncim dhe pjesëmarrje qytetare





Lajme dhe publikime të përditësuara

## 2. Si ta gjej dhe si të hyj në platformë


1. Hapni një motor kërkimi (p.sh. Google, Bing, Yahoo).  
Shkruani në shiritin e kërkimit: [rrjetantikorrupsion.al](http://rrjetantikorrupsion.al).



2. Klikoni rezultatin zyrtar me këtë adresë:  
[www.rrjetantikorrupsion.al](http://www.rrjetantikorrupsion.al)




3. Do të hapet faqja kryesore, ku mund të shihni njoftime të fundit, publikime, ose të vazhdoni me regjistrim/hyrje.



# 3. Si të regjistrohem dhe të krijoj llogari

1. Klikoni butonin “Regjistrohu” në këndin e sipërm të djathtë.



2. Plotësoni formularin me:

Emrin dhe mbiemrin


Emailin personal ose të organizatës

Lloji i përdoruesit


Fjalëkalimin (password) që zgjidhni vetë

Opsionalisht: emrin e organizatës

3. Klikoni “Dërgo” ose “Krijo llogari”.
4. Mund të merrni një **email konfirmimin** – hapeni dhe klikoni linkun për aktivizim.



5. Pasi të keni llogari, mund të hyni nga butoni “Hyr” duke përdorur emailin dhe fjalëkalimin tuaj



## 4. Seksionet kryesore të platformës

Seksioni	Cfarë Përmban	Si Përdoret
Kreu	Lajmet më të fundit, aktivitetet e reja, nismat kryesore.	Shfletoni për të marrë panoramë të shpejtë.
Rreth Nesh	Informacione për misionin, partnerët dhe qëllimet e rrjetit.	Lexoni për të kuptuar misionin e platformës.
Anëtarët	Lista e OSHC-ve, institucioneve dhe mediave të përfshira.	Shikoni me kë mund të bashkëpunoni.
Publikime	Artikuj, raporte, manuale, materiale informuese.	Shkarkoni ose lexoni online dokumentet.
Forumi	Hapësirë diskutimi për tema mbi drejtësinë dhe korrupsionin.	Regjistrohuni dhe merrni pjesë me komente dhe ide.
Denonco / Konsulto	Mekanizma për të raportuar, dhënë mendime ose marrë pjesë në sondazhe.	Përdorni formularët e thjeshtë për të kontribuar.

## 5. Si të kontribuoj dhe të përfshihem



Publiko artikuj ose opinione mbi çështje që lidhen me transparencën dhe korrupsionin



Ngarko raporte apo studime për ta ndarë me komunitetin.



Diskuto në forume duke hapur tema të reja ose duke komentuar tek ekzistueset.



Merr pjesë në sondazhe që matin perceptimin e qytetarëve për korrupsionin.



Denonco raste të korrupsionit ose shkelje ligjore duke përdorur mekanizmat e raportimit.

## 6. Anëtarësimi dhe roli i përdoruesit



Si anëtar i rrjetit, fiton qasje të plotë në të gjitha seksionet.



Ke mundësinë të **propozosh nisma**, të marrësh pjesë në trajnime dhe të përfaqësosh organizatën tënde.



**Përdoruesit priten të respektojnë:**


- Etikën në komunikim
- Bazimin në fakte kur bëjnë publikime
- Ruajtjen e sigurisë së informacionit personal

## 7. Këshilla për përdorim efikas


- Përdorni **fjalë kyçe** kur kërkoni publikime (p.sh. “drejtësia”, “reforma”, “antikorrupsion”).
- **Kontrolloni datën e dokumenteve** për të siguruar që po përdorni informacion të përditësuar.
- **Shfrytëzoni materialet multimediale** (video, infografika) për ta bërë informacionin më të kuptueshëm.
- **Angazhohuni në forume**, duke kontribuar me ide të ndërtuara.

## 8. Mbështetje dhe kontakt

- Klikoni te butoni **“Kontakt”** në platformë për çdo pyetje.



- Për mbështetje teknike ose problem me llogarinë, shkruani në adresën zyrtare të emailit (e dhënë te seksioni “Kontakt”).



- Lexoni gjithmonë politikat e privatesisë, për të kuptuar se si mbrohen të dhënat tuaja.

